



## **STATUTI I SHOQATËS “CONFEUROPA IMPRESE ALBANIA”**

### **KREU I – PARIMET**

#### **NENI 1**

##### **EMËRTIMI DHE OBJEKTI I AKTIVITETIT**

“CONFEUROPA IMPRESE ALBANIA” pjesë e CONFEUROPA IMPRESE-KONFEDERATË KOMBËTARE E SHOQËRIVE TREGTARE, në vazhdim do të quhet (SHOQATA), përfaqëson dhe mbron interesat socialë, moralë dhe ekonomikë të subjekteve tregtarë dhe profesionalë që operojnë në sektorin e ndërmjetësimit, industrisë, artizanatit, tregtarë, bujqësisë si dhe në aktivitete ekonomike në treg në territorin e Republikën e Shqipërisë;

Shoqata aderon në Konfederatën Kombëtare CONFEUROPA Imprese, pranon Statutin, Kodin Etik, Kartën e Vlerave, parimet inspiruese dhe rregullat e sjelljes të parathënies.

Shoqata përfaqëson në mënyrë të drejtë për drejtë CONFEUROPA IMPRESE në Shqipëri.

Ajo nuk mund të ketë qëllime përfitimi dhe nuk mund të ketë asnjë lidhje me parti ose levizje politike. Mund të aderojë në Ente dhe Organizata vendore, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare në harmoni me objektivat socialë të shoqatës.

Shoqata e ka selinë në Tiranë në Rrugën Bilal Golemi, Nr. 1, në afërsi të Parkut Olimpik, por mund të ketë edhe seli të tjera dytësore në të gjithë Republikën e Shqipërisë sipas vendimeve të organeve drejtuese.

Kohëzgjatja e Shoqatës është pa afat.

#### **NENI 2**

##### **OBJEKTIVAT**

Shoqata, në interesin e përgjithshëm të anëtarëve:

Ajo themelohet dhe e bazohet në vlerët që karakterizojnë traditën e lirë dhe demokratike të shoqatave, në këtë kuptim themelon statutin e saj sipas këtyre parimeve:

- Mbron dhe përhap një model të rrjeti të ndërkombëtarizimit në territor, në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe në organizimet e biznesit ose shoqërive tregtare;
- Promovon dhe intensifikon marrëdhënien dhe shkëmbimet tregtare dhe industriale nëpërmjet një rrjeti biznesesh midis vendeve të ndryshme;
- Ofron informacione të sakta dhe të gatshme dhe krijon partneritete midis anëtarëve dhe rrit numrin e anëtarëve;

- Mbështet konceptin e konkurrencës dhe të tregoj që “Made in Italy” dhe “Sistemi Confeuropa Imprese” janë më shumë se një etiketë;
- Esportimi dhe shitja jashtë shtetit të produkteve të veta;
- Të krijoj aleanca me partnerët dhe të realizoj njësi prodhuese në vende të huaja;
- Hapjen e mundësive të reja tregtare dhe delokalizimin e aktivitetit të shoqërive tregtare;
- Fokalizimi i një ose më shumë produkteve që konsiderohen të përshtatshëm për një ose më shumë tregje të jashtëme;
- Ekzistenca e mundësive të biznesit të favorshme dhe kontaktimi me klientët ose furnitorë të jashtëm;
- Të kontaktojë me partnerë potencialë për krijimin dhe tërheqjen e kapitaleve të huaja;
- Nevojën për tu furnizuar pranë furnitorëve të jashtëm;
- Kërkon kushte avantazhuese për të ulur shpenzimet (presion më të ulët fiskal, kosto më të ulët të punës)
- Të aplikoj legjislacionin e sektorit;
- Të shfrytëzoj financimet e fondeve europiane dhe publike;
- Të shfrytëzoj punën kërkimore universitare të aplikuar në industri;
- Të shfrytëzoj mundësitë për ndërkombëtarizim;
- Të ndërtoj modele organizimi për shoqëritë tregtare;
- Të marrë leje dhe autorizime për zhvillimin e aktiviteteteve tregtare dhe prodhuese;
- Të favorizoj zhvillimin e shoqërive;
- Lirinë e pjesëmarrjes në shoqatë si liri e personit dhe e grupeve shoqërore;
- Pluralizmi si pasojë e lirisë politike dhe ekonomike dhe burim i zhvillimit për subjektet, sipërmarrjet dhe shoqërinë civile;
- Demokracia e brendshme si rregull kryesor për organizimin dhe refleks të demokracisë politike dhe ekonomike që Shoqata promovon;
- Solidariteti, karta e vlerave dhe kodi etik midis anëtarëve dhe kundrejt shtetit si karakteristikë kryesore e natyrës së shoqatës;
- Përgjegjësia kundrejt anëtarëve dhe kundrejt sistemit ekonomik dhe social me qëllim zhvillimin e drejtë dhe të integruar;
- barazia midis anëtarëve nga pikëpamja e dinjitetit të barabartë përpara ligjit dhe institucioneve;

- pjesëmarrja në zhvillimin e shërbimeve të lidhur me evolucionin e realitetit shoqëror, si kontribut në mirëqenien e gjithë kolektivitetit dhe europëzimit si formë kryesore në realitetin aktual historik, për të ndërtuar një ambient me bashkëjetëse rritëse ndërtuese dhe të bashkëpunimit paqësor midis shteteve.

Shoqata impenjohet të impostoje veprimin e saj, si model referimi për anëtarët, në krahasim me rregullat e mëposhtme të sjelljes:

- zbatimin me besnikëri të kartës së vlerave, të Kodit etik, të ligjeve dhe të detyrimeve të nëshkruara, dhe sipas frymës së statutit, promovimin e një ndërgjegjje të shoqatës e cila është në kundërshtim me cdo praktikë të paligjshme në dëm të pasurisë, të sipërmarrjes dhe personave të cfarëdo lloj forme;
- Respekton dhe promovon intersat e ligjshëm të anëtarëve dhe në mënyrë të vecantë të drejtën e tyre për të pasur një informin të plotë dhe korrekt;
- Ndjenjën e përgjegjësisë dhe të kontributit aktiv për mbrjotjen e ambientit dhe të territorit në të cilin vepron;
- Pjesëmarrjen aktive të anëtarëve në veprimtarinë e Shoqatës në të gjithë nivelet, në format dhe mënyrat e përcaktuar nga organet;
- Sjellje morale dhe profesionale me integritet të anëtarëve dhe në mënyrë të vecantë të antarëve që mbajnë detyra në orgagen e brendshme dhe të jashtëm të Shoqatës;
- Kryerjen e detyrave të shoqatës ose publike me frymën e shërbimit e disponibilitetit për ti shërbyer shoqatës atëherë kur një interes më i lartë për shoqatën e kërkon;
- Detyrimi për ta garantuar një cilësi të lartë imazhit dhe të emrit të shoqatës në cdo lloj veprimtari edhe të jashtëm të shoqatës dhe punës;

Shoqata drejtohet nga statuti i cili lexohet, aprovohet dhe nënshkruhet nga të pranishmit, si cili bashkëlidhet këtij akti i cili bëhet pjesë integrale e substanciale.

## **KREU II – RAPORTET E ANËTARËVE**

### **NENI 3 ANËTARËT**

- Mund të marrin pjesë në Shoqatë në cilësinë e anëtarëve të gjithë, persona fizike ose juridike, që ushtrojnë brenda territorit aktivitet të sipërmarrjes ose të vetëpunësuar ose cdo lloj forme tjetër ndihmëse ose profesionale;

- Mundet të anëtarësohen në cilësinë e anëtarëve sipërmarrës të moshuar, organizata të tjera që kanë qëllime dhe objektiva në harmoni me shoqatën, si dhe grupe organizatash dhe shoqërive tregtare sipas kushteve të vendosura;
- Mundet të anëtarësohen gjithashtu sipërmarrësit e ardhshëm në fushat e caktuara nga departamentet.

#### NENI 4

#### **ANËTARËSIMI: FORMA DHE KUSHTET**

- Për tu anëtarësuar në Shoqatë, duhet që të paraqitet një kërkesë, e nënshkruar nga titullari ose nga një përfaqësues ligjor i shoqërisë tregtare, mbi këtë kërkesë vendos Giunta Brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës;
- Në rast se kërkesa do të refuzohet, vendimi i refuzimit duhet të njoftohet të interesuarit me postë rekomande Brenda 60 ditëve. Mungesa e njoftimit brenda afatit është e barasvlefshëm me pranimin e kërkesës;
- Kundër vendimit të Giuntës mund të bëhet ankim brenda 90 ditëve nga njoftimi në Këshill, i cili duke marrë edhe mendimin e Kolegjit probiviri vendos Brenda 30 ditëve duke i njoftuar të interesuarit;
- Anëtarësimi impenjon anëtarin ligjërisht dhe sipas statutit për tre vite, duke filluar nga 1 janari ose nga 1 korriku pasardhës nga data e anëtarësimit. Nga ajo datë fillojnë të gjitha detyrimet dhe të drejtat e lidhura me shoqatën;
- Anëtarësimi konsiderohet i rinovuar në heshtje cdo tre vjet nëse nga anëtari nuk është bërë kërkesë me shkrim për largimin të paktën 3 muaj përpara përfundimit të afatit me anë të postës rekomande ose me deklaratë të firmosur dhe dorëzuar në selinë e Shoqatës;
- Anëtarësimi në Shoqatë, anëtari merr cilësinë e anëtarit edhe në sistemin Konfederal dhe passjell pranimin e këtij statute dhe të atij konfederal;
- Anëtarët janë të detyruar të paguajnë shoqatës kuotën e anëtarësisë e cila rrjedh nga detyrimet e marra nga kontrata kolektive, nga vendimet e konfederatës kombëtarë të shoqërive tregtare dhe nga vendimet e shoqatës në masën dhe mënyrën e parshikuar nga organet përgjegjës;
- Vetëm nëse janë në rregull me kontributet e shoqatës mund të ushtrohen të drejtat në organet sipas nenit 11, ose përfaqësohet Shoqata në ente dhe komisione sipas nenit 2, shkronja F;

- Presidenti i Shoqatës, duke marrë mendimin e Giuntës, mund të veproj ligjërisht kundër anëtarëve të cilët nuk kanë paguar kuotën e anëtarësisë;
- Strukturat e parashikuara ne nenet 8 dhe 9 të këtij statute, me qëllim koordinimin e përshtatshëm dhe në zbatim të statutit, dorëzojnë cdo vit Shoqatës listën e anëtarëve të tesaruar nëpërmjet tyre me skedat përkatëse dhe kërkesat e firmosura;

### **NENI 5**

#### **LARGIMI DHE PËRJASHTIMI**

Cilësia e anëtarit humbet:

- Me anë të largimit sipas parashikimeve të nenit 4 paragrafi 6. Largimi nuk e përjashton anëtarin nga anëtarin nga detyrimet finciare të ndërmarra me mënyrat dhe kushtet e parashikuara nga neni 4;
- Me anë të përjashtimit të vendosur nga Giunta si pasojë e kundërshtimeve të rënda me drejtimit politike të përgjithshme të vendosura nga Konfederata ose nga organet kompetente të Shoqatës ose për shkelje të rënda dhe të vazhdueshme të normave të këtij statute, ose nga humbja e kritereve bazë me të cilin është pranuar si anëtar;
- Per shkak të mos pagesës së kuotës së anëtarësisë;
- Per shkak të mbylljes së Shoqatës të vendosur nga asamblea sipas menyrave të parashikuar në këtë statut. Humbja e cilësisë si anëtar sjell humbjen e cdo të drejte mbi pasurinë e shoqatës.

### **NENI 6**

#### **SANKSIONET**

Shkallët e sanksioneve që aplikohen nga Këshilli me propozim të anëtarëve ose personave të përfshirë për rastet e shkeljeve të statutit janë sipas këtij rendi:

- a) Paralajmërim me shkrim;
- b) Pezullimi;
- c) Humbja e së drejtës.

Sanksioni i shkronjës b) pengon pjesëmarrjen në aktivitetet e organeve.

### **NENI 7**

#### **INKUADRIMI I DYFISHTË**

- Inkuadrimi i njëkohshëm i shoqërive tregtare në shoqatën kombëtare dhe atë rajonale përbën faktor esencial të bashkimit organizativ dhe sindakal.
- Shoqata kujdeset për zbatimin e inkuadrimit të dyfishtë sipas të cilit aderimi në Shoqatën Kombëtare sjell automatikisht aderimin në shoqatën rajonale dhe e kundërta;

- Detyrën për të vendosur për mosmarrëveshjet organizative dhe kontributive të lidhura me inkuadrimin e dyfishtë e ka një koleg arbitral i kryesuar nga një i deleguar nga Konfederata dhe e përbërë nga përfaqësues i shoqatës dhe nga një përfaqësues i Shoqatës Kombëtare.

### **KREU III – ORGANIZIMI TERRITORIAL DHE E KATEGORIVE**

#### **NENI 8**

#### **ORGANIZIMI TERRITORIAL**

Me qëllim arritjen e qëllimeve sipas nenit 2 Asamblea e Shoqatës në respektim të kriterëve ekonomike, të eficiencës organizative dhe të përfaqësimit, mund të ndajë territorin e rajonit dhe të qarkut në mbledhje nenrajonale/provincial/lokal, duke përcaktuar natyrën, funksionet dhe kompetencat.

#### **NENI 9**

#### **ORGANIZIMI I KATEGORIVE**

- Anëtarët e Shoqatës janë organizuar në Sindakata rajonale kategorive të cilët mbledhin biznese ose shoqëri tregtare anëtarë në atë territory që bëjnë pjesë në të njëjtën kategori, ose në sektore homogjenë të përbëra nga kategori të ngjashëm për sa i përket fushës së veprimtarisë ose sindakatës që bëjnë pjesë;
- Këto struktura mbrojnë interesin e kategorive dhe shoqërive tregtare që e përbëjnë dhe e promovojnë zhvillimin ekonomik dhe teknik në lidhje me problematikat specifike të sektorit, në bashkërendim me Shoqatën dhe organizatat e tjera kombëtare të kategorisë;
- Shoqata merr përsipër dhe kujdeset drejt për së drejti për interesat e operatorëve në territorin të cilët bëjnë pjesë në ndarjet merceologjik ose në sektorët që nuk kanë një sindakatë lokale kategorive.

#### **NENI 10**

#### **RAPORTI ME SHOQATËN**

- Strukturat e parashikuara nga nenet 8 dhe 9, gjatë punës së tyre me Ente, Organizma ose Autoritete vendore, rajonale dhe në organizimin e seminareve, asambleve ose manifestime të ndryshme janë të detyruar të informojnë paraprakisht Shoqatën për tu vënë dakord në lidhje me orientimin për tu ndjekur.
- Në rast se Shoqata vërteton që nga ana e strukturave ka pasur mos zbatim të normativave të statutit, mungesë efieience, pasivitet ose përfaqësim në nivel të dobët, atëherë mund të marrë menaxhimin e drejtë për drejtë të veprimtarive, në rast se e konsideron të nevojshëm mund të emëroj një përfaqësues ose një komisar në analogji me sa është parashikuar në Statutin Konfederal me marrëveshje me shoqatat kombëtare të kategorisë të interesuara.



- Çdo strukturë është e detyruar të kujdeset për mbledhjen e kontributeve të anëtarësisë në favor të shoqatës kombëtare ose rajonale në masen dhe në mënyrën e vendosur sipas statutit.

**KREU IV**  
**ORGANET E SHOQATËS**  
**NENI 11**  
**ORGANET**

Janë Organe të Shoqatës:

- Asamblea e përgjithshme;
- Këshilli;
- Presidenti;
- Këshilli i kontabilistëve;

**NENI 12**  
**KOHËZGJATJA E ORGANEVE**

- Organet e Shoqatës zgjidhen me votim sekret.
- Të zgjedhurit në organet kolegjiale nuk mund të delegojnë tek të tjerët funksionet e tyre dhe ato humbin funksionin e tyre në rast së mungojnë pa arsye për 3 mbledhje të një pas njëshme.
- Organet e zgjedhura kanë një afat prej 3 vitesh.
- Presidenti dhe Zv. Presidenti të cilët kanë mbajtur për dy mandate të një pas njëshëm funksionin e tyre nuk mund të zgjidhen në mënyrë të menjëhershëm në të njëjtin funksion.
- Nuk mund të mbajë asnjë pozicion në shoqatë ose e humb pozicionin që ka cilido që shkel rregullat e statutit ose nuk është në rregull me pagesat e kontributeve të prapambetura të mëparshëm.

**NENI 13**  
**PA PAJTUESHMËRIA**

- Pozicionet e Presidentit, Zv. Presidentit, sekretarit të përgjithshëm si dhe anëtarët e Giuntës janë të pa pajtueshëm me detyra me karakter politik të cilat janë shoqëruar me detyra qeveritare në nivel të administratës publike lokale, qendror dhe mandat të deputetit dhe detyra të tjera politike;
- Nuk përbën papajtueshmëri detyra e ngarkuar sipas një akti përfaqësimi të një institucioni ligjërish të njohur nga ana e Shoqatës.

**NENI 14**  
**ASAMBLEA: PËRBËRJA**

- Asamblea e Shoqatës është e përbërë nga të gjithë anëtarët të cilët janë në rregull me pagesën e anëtarësisë dhe me normativat e statutit;



- Parimet e përfaqësisë janë parashikuar në statutin konfederal;
- Parimet për votimet janë përcaktuar në një rregullre të posacme;
- Asnjë pjesëmarrës në asamble nuk mund të jetë mbajtës i dy ose më shumë detyrave ose përfaqësimit.
- Mund të marrin pjesë në asamble anëtarët e organeve të shoqatës të parashikuar në statut, Sekretari.

#### **NENI 15**

##### **ASAMBLEA: PRESIDENTI, SEKRETARI DHE E NUMËRUESIT**

- Asamblea emëron Presidentin e Shoqatës, tre ose pesë numërues dhe sekretarin, i cili mund të zgjidhet edhe nga persona të jashtëm nga anëtarët e asamblesë;
- Kur duhet të rimërohen pozicionet e detyrave në Shoqatë , ndryshimet e statutit ose shkrirjen e shoqatës sekretari duhet të jetë një noter ose një përfaqësues i Konfederatës.

#### **NENI 16**

##### **ASAMBLEA: THIRRJA DHE ZHVILLIMI**

- Mbledhja e asamblesë, e zakonshme ose e jashtëzakonshme thirren nga presidenti i shoqatës ose nga zevendësuesi i tij;
- Në mbledhje të zakonshme asamblea thirret një herë në vit, me anë të njoftimit me shkrim anëtarëve ose me anë të njoftimit të publikuar në organin informues të Shoqatës ose me anë të njoftimit publik në media të paktën 15 ditë përpara ditës së mbledhjes;
- Njoftimi për thirrjen duhet të përmbajë: rendin e ditës, vendin, ditën, muajin dhe orën e mbledhjes si dhe informacione në lidhje me një mbledhje të dytë të mundshme e cila duhet të fiksohet të pakën një orë pas mbledhjes së parë. Në rast se në rendin e ditës është miratimi I bilancit, njoftimi I mbledhjes duhet të përmbajë njoftimin për tu njohur dokumentat në lidhje me bilancin dhe vendin ku mund të njihen me këto dokumenta;
- Asamblea mund të thirret në mbledhje të jashtëzakonshme kur Presidenti i Shoqatës ose i Këshillit e konsiderojnë të nevojshëm ose me anë të kërkesës të motivuar të Kolegjit të audituesve;
- Ne rast se mbledhja është thirrë me kërkesë të Kolegjit të Audituesve Presidenti duhet ta caktojë Brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës. Nëse Presidenti nuk e thërrët asamblenë atëherë Brenda 10 ditëve e thërrret Kryetari i Kolegjit të Audituesve;



- Në raste urgjente, Asamblea mund të thirret me mjete telegrafike me njoftim të paktën 5 ditë përpara mbledhjes.

#### **NENI 17**

#### **ASAMBLEA: VLEFSHMËRIA**

- Mbledhjet e Asamblesë janë të vlefshme në mbledhjen e parë kur janë të pranishëm, edhe me përfaqësim gjysma e anëtarëve plus një. Janë të vlefshme në mbledhjen e dytë me cfarëdolloj pjesëmarrje;
- Presidenti i Asamblesë vendos, cdo herë mënyrën e votimeve, përvec rasteve kur asamblea vendos ndryshe ose kur mënyra e votimit është parashikuar shprehimisht në këtë statut;
- Vendimet merren me shumicën e të pranishmëve;
- Në votimet e hapura, në rast të barazisë së votive, fiton pala që përmban edhe votën e Presidentit: Në votimet sekrete propozimi konsiderohet I rrëzuar;
- Në rast të barazisë së votive për zgjedhjen e detyrave për organet e Shoqatës do të deklarohet I zgjedhur anëtari që është anëtarësuar më përpara në Shoqatë;
- Për ndryshimet e Statutit është e nevojshme vota pro e të paktën gjysma plus një e anëtarëve që kanë të drejtën e votës. Ndryshimet e Statutit mund të vendosen edhe nëpërmjet referendumit;
- Për mbylljen e Shoqatës është e nevojshme vota pro e të paktën 75% të anëtarëve që kanë të drejtë vote.

#### **NENI 18**

#### **ASAMBLEA: KOMPETENCAT**

- Asamblea në mbledhje të zakonshme:
  - Përcakton drejtimitet e politikave sindakale dhe të përgjithshme të Shoqatës të cilat janë të detyrueshme për të gjitha strukturat, pjesëtarëve dhe anëtarëve;
  - Zgjedh cdo tre vjet me votime sekrete Këshillin e Shoqatës e Shoqatës midis anëtarëve të Asamblesë të cilët kanë të drejtë vote;
  - Zgjedh cdo tre vjet me votime sekrete, detyrat e tjera të shoqatës të cilat zgjidhen nga asamblea të parashikuar në Statut;
  - Brenda 30 qershorit të cdo viti aprovon bilancin përmbledhës të vitit pararendës dhe relation mbi aktivitetet e zhvilluar nga Shoqata si dhe bilancin preventiv të vitit pasrendës dhe drejtimeve për tu ndjekur;
  - Vendos mbi cdo argument tjetër të cilin e ka në rendin e ditës së mbledhjes.

- Asamblea në mbledhje të jashtëzakonshme:
  - Vendos ndryshimet e këtij Statuti;
  - Vendos shkrirjen e Shoqatës duke përfshirë caktimin e likuiduesit dhe mënyrën e likuidimit;
  - Vendos për cdo argument tjetër të caktuar në rendin e ditës.

### **NENI 19** **KËSHILLI: PËRBËRJA**

Këshilli i Shoqatës është i përbërë nga një numër maksimal prej 25 anëtarësh duke përfshirë edhe Presidentin në mënyrë që të garantojë një përfaqësim të përshtatshëm të përfaqësuesve të departamenteve që bëjnë pjesë:

- Arti dhe kultura, arsimi, formimi profesional dhe Universiteti
- Aktivitete no profit dhe mashat e treta
- Broker sigurimesh dhe financiar
- Tregti, turizëm dhe horeka (hoteleri, restorant, kafe)
- Energjia dhe ambienti
- Infrastruktura, transporti dhe llogjistika
- Ndërkombëtarizimi dhe marrëdhënie me institucionet
- Bizneset e vogla dhe të mëdha
- Politikat komunitare dhe ndërkombëtare
- Politikat e bashkimit territorial
- Politikat industriale
  - industria agro-ushqimore, vitikultura dhe enologjia
  - industria e produkteve hidraulike, pneumatike dhe shufrave të kromatizuara
  - industria e drurit
  - industria metalmekanike
  - industria oil & gas
  - tekstili, moda dhe aksesoret
  - Profesionet dhe shërbimet
- Shëndetësia, mjekësia dhe farmacia, sport dhe mirëqenie;

- Shtypi dhe komunikimi, teknologjia e informacionit dhe e komunikimit.

Anëtarë të zgjidhur nga asamblea midis anëtarëve të cilët kanë të drejtën e votës.

#### **NENI 20 PRESIDENTI**

- Mund të zgjidhet president i Shoqatës cdo sipërmarrës anëtar ose person i deleguar nga shoqëria tregtare e anëtarësuar në rregull me parashikimet e neneve 3 dhe 4 të Statutit.
- Presidenti përfaqëson Shoqatën ligjërisht dhe sipas statutit, ka të drejtën e firmës të cilën mund ta delegoj me akt të posacëm;
- Presidenti gjithashtu:
  - Menaxhon Shoqatën, zbaton vendimet e organeve kolegjiale dhe ndërmerr masat e nevojshme për arritjen e objektivave të Shoqatës;
  - Mundët të filloj procese gjyqësore dhe të mbrohet si dhe të caktoj avokatë dhe përfaqësues për mosmarrëveshjet;
  - Mund të ndërmarrë veprime, të cilat nuk janë parashikuar në Statut për organe të tjera, të cilat janë të nevojshëm për interesin e Shoqatës;
  - Vëzhgon zhvillimin e shërbimeve dhe akteve administrative;
- Mund të zëvendësoje Këshillin e Presidencës dhe Giuntën e Presidencës në raste urgjente, por duke referuar për masat e marra në mbledhjen e parë të mundshme për konvalidimin e tyre;
- Në rast se detyra e Presidentit mbetet vakante, Zv. Presidenti merr kompetencat e Presidentit dhe thërret Brenda 30 ditëve nga vakanca asamblenë e cila sipas parashikimeve të nenit 18 të këtij statute zgjeddh Presidentin e ri.

#### **NENI 21 KOLEGJI I AUDITUESVE KONTABËL**

- Kolegji i audituesve ligjore të llogarive përbëhet nga pesë anëtarë, tre efektivë dhe dy zëvendësues, të emëruar nga Asamblea edhe jashtë anëtarësisë;
- Në mbledhjen e parë të Kolegjit anëtarët efektive zgjedhin midis tyre Kryetarin i cili duhet të jetë i regjistruar në Urdhrin e Audituesve Ligjore. Në rast se vendi i kryetarit ngelet vacant, Kolegji në mbledhjen pasardhëse zgjedh kryetarin e ri të Kolegjit. I zgjedhuri i ri mban mandatin deri në përfundim të afatit të mandatit të kryetarit që ishte në vazhdim;
- Në rast të vakancave atëherë ndërhyjnë anëtarë të tjerë.

## **NENI 22**

### **KOLEGJI I AUDITUESVE LIGJORE: FUNKSIONET**

- Kolegji i audituesve ligjore ka funksione verifikimin e llogarive dhe kontrollin e menaxhimit administrative të Shoqatës, veprimtari për të cilën jep llogari tek organet e Shoqatës;
- Kryetari i audituesve mund të marrë pjesë pa të drejtë vote në mbledhjen e organeve;
- Kolegji përpilon një relacion vjetor të cilën e paraqet në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme në mbledhjen e për aprovimin e bilancin e vitit pasardhës;
- Kolegji i audituesve ka mundësi që me një relacion të motivuar dhe të aprovuar me unanimitet, në raste të pasaktësive të rënda në llogari të dokumentuara, ti kërkojë Presidentit thirrjen e Këshillit. Në rast se Presidenti nuk i konsideron të bazuara arsyet dhe nuk thërret Këshillin brenda 10 ditëve, atëherë çështja kalon tek Kolegji Provirori I cili shprehet për thirrjen e asamblesë brenda një afati prej 15 ditësh;
- Detyra e audituesit është e papajtueshme me çfarëdo lloj tjetër detyre brenda Shoqatës.

## **NENI 23**

### **POZICIONET SOCIALE: ZGJEDHJET**

Mund të zgjidhen në pozicionet e shoqatës operatorët ose ndihmësit që zhvillojnë aktivitetin e tyre edhe në mënyrë jo të përhershme në sektorin që do të përfaqësoj; përfaqësuesit ligjorë ose cdo person tjetër i pajisur me autorizim në shoqëritë e kapitaleve ose me prokurë të posacm; një nga ortakët në rast të shoqërive në emer personal.

## **NENI 24**

### **SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës është përgjegjësi i personaletit dhe i aktiviteteve organizative të funksionimit normal të zyrave, të ruajtjes së dokumentave dhe menaxhimit të personelit. Ndiemon Presidentin dhe organet kolegjiale në zhvillimin e mandatit të tyre. merr pjesë në mbledhjen e organeve të shoqatës si konsultues dhe merr rolin e sekretarit të përgjithshëm kur kjo detyrë nuk është parashikuar shprehimisht që të merret nga një noter ose nga një i deleguar i konfederatës.

## **NENI 25**

### **DEPARTAMENTET**

Brenda Shoqatës janë krijuar Departamentet e mëposhtëme:

- Arti dhe kultura, arsimi, formimi profesional dhe Universiteti
- Aktivitete no profit dhe mashat e treta;
- Broker sigurimesh dhe financiar;
- Tregti, turizëm dhe horeka (hoteleri, restorant, kafe);
- Energjia dhe ambient;
- Infrastruktura, transporti dhe llogjistika;
- Ndërkombëtarizimi dhe marrëdhënie me institucionet;
- Bizneset e vogla dhe të mëdha;
- Politikat komunitare dhe ndërkombëtare;
- Politikat e bashkimit territorial;
- Politikat industrial;
  - industria agro-ushqimore, vitikultura dhe enologjia;
  - industria e produkteve hidraulike, pneumatike dhe shufrave të kromatizuara;
  - industria e drurit;
  - industria metalmekanike;
  - industria oil & gas;
  - tekstili, moda dhe aksesoret;
  - Profesionet dhe shërbimet;
- Shëndetësia, mjekësia dhe farmacia, sport dhe mirëqenie;
- Shtypi dhe komunikimi, teknologjia e informacionit dhe e komunikimit.

Departamentet kanë si detyrë që të përfaqësojnë në shoqatë bashkarisht kërkesat e e ndryshme që vijnë nga sektore ose departamente dhe duhet të kontribuojnë në individualizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve politiko-sindakale të shoqatës;

Fuksionimi i departamenteve rregullohet nga një rregullore e aprovuar sipas parashikimeve të Sistemit Confeuropa Imprese.

**KREU V**  
**PASURIA E SHOQATËS – ADMINISTRIMI – BILANCI**  
**NENI 26**  
**PASURIA E SHOQATËS**

Pasuria e Shoqatës formohet nga:



- nga pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe vlera të fituara nga Shoqata në bazë të një titulli të ligjshëm pronësie;
- nga shuma monetare të fituara me cdo lloj titulli deri kur nuk janë shpërndarë.

Të ardhurat e Shoqatës janë formuar nga:

- kontributet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të vendosura nga organet e Konfederatës kombëtare të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe nga organet pjesëmarrëse të Shoqatës;
- Dhurime vullnetare;
- Të ardhura të ndryshme, si dhe cdo e ardhur tjetër e vendosur nga Këshilli.

#### **NENI 27**

#### **VITI FINANCIAR**

Viti financiar ushtrohet nga data 1 Janar deri në 31 Dhjetor të cdo viti.

#### **NENI 28**

#### **ZGJIDHJA OSE MBYLLJA E SHOQATËS**

- Mbyllja e Shoqatës vendoset nga Asamblea, në mbledhje të jashtëzakonshme, e cila duhet të jetë e përbërë nga një numër të paktën 75% të votave dhe vendimarrja duhet të ketë të paktën 75% të votuesve.
- E njëjta asamble me të njëjtën shumicë votash do të përcaktojë edhe emërimin e likuiduesve duke përcaktuar edhe detyrat dhe mënyrat e likuidimit.

#### **NENI 29**

#### **DISPOZITAT E FUNDIT**

Për sa nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut, duhet ti referohemi dispozitave të Statutit të Confeuropa Imprese-Konfederatë kombëtare të shoqërive tregtare dhe të rregullave të Sistemit Confeuropa Imprese të adoptuara nga ato, në rast nuk zgjidhet as në këtë mënyrë atëherë do të aplikohen normat e Kodit Civil.

Statuti u lexua dhe perkthye, ne menyre stimultane ne gjuhen Angleze, nga Notere Albana Spahiu, perkthyes zyrtare e gjuhes angleze, e licensuar nga Ministria e Drejtesise.

Ky Statut shpreh vullnetin e themeluesve.

Nenshkrimet e themeluesve: